# RAPORT

# I VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Për Programin e studimit Master Profesional në

## Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit

***Oftuar nga Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë***

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

**Prof.Dr. Shyqyri LLACI**

**Nëntor 2016**

# RAPORTI I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master Profesional në Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit**

| | Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit: | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | Urdhër Nr. 264, datë 28.06.2013 Urdhëri i riorg: Nr. 433, datë 12.11.2015 |
| 4 | Titulli i programit të studimit: | Master Profesional në Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit për UNIZKM dhe "Master universitario di primo livello in Start up di Impresa nel settore turistico" për Universitetin e Bolonjës, Itali |
| 5 | Cikli i studimit: | Master Profesional |
| 6 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vjet |
| 7 | Kreditet në total (ECTS): | 60 |
| 8 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 9 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip/Italisht |
| 11 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Po * |
| 12 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Po ** |
| 13 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Jo |
| 14 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 7 |
| 15 | Aktivizimi i programit të studimit | 2015 |
| 16 | Numri i studentëve | 6 |

*Programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin "Alma Mater" Bolonjës, Itali

** Master Profesional në Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit" për UNIZKM dhe "Master universitario di primo livello in Start up di Impresa nel settore turistico" për Universitetin e Bolonjës, Itali

## Hyrje

Me Vendimin të Këshillit te Ministrave Nr. 567 date 27.08.2004 u themelua Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe si me fillimin e vitit akademik 2004-2005 procesi mësimor startoi me Fakultetin e Mjekësisë dhe me Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Politike sot Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale.,

Gati 7 vjetë më vonë, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 670 date 28.09.2011, *"Për ndryshimin e emertimit, nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" ne Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"*, të Qeverisë Shqiptare dhe me iniciativen e Fondacionit me të njejtin emer u themelua Universiteti sot Katolik i Tiranes "Zoja e Keshillit te Mire".
UniKZKM përmban në strukturen e vet kater Fakultete ndër të cilet edhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale hapi në vitin akademik 2004-2005 e në vijim Programin e studimit Bachelor në "*Ekonomi Ndërmarrjeje*", - si program i studimit i ciklit të parë, dhe është projektuar për të ofruar një formim të thelluar në fushën ekonomike në përgatitjen e specalistëve të afta për të mbuluar me sukses role këshilluese dhe menaxhuese në sektorin publik dhe privat, brenda dhe jashtë vendit. Në këtë Fakultet ofrohet edhe Masteri i Shkencave në *Ekonomi dhe Menaxhim* si dhe programi i ciklit të tretë të Studimeve, Doktoraturë në "*Statistikë* që nga viti akademik 2013-2014.

Në vitin akademik 2015-2016 startoi programi Master Profesional në *"Ngritje dhe Zhvillim i Sipermarrjes ne Sektorin e Turizmit"*

Zanafilla e këtij masteri është e hershme qysh në bashkepunimi me Universitetin e Bolonjes në vitin 2005 me nënshkrimin e një marrëveshje kuadër bashkëpunimi. Në vijim ky bashkëpunim u konkretizua me realizimin e një *programi të përbashkët* studimi "*Master Profesional në Menaxhim Financiar dhe Menaxhim Risku*", i cili u zhvillua në disa edicione (i akredituar) por që pati një ndërprerje disa vjecare derisa vijmë në këtë bashkëpunim për të nënshruar në vitin 2015.

Ky programi studimit, i hapur me Urdhër të MASH, Nr.264, date 28.06.2013, për Hapjen e programit te ri të ciklit të dyte te studimeve Master Profesional ne "*Ngritje dhe Zhvillim i Sipermarrjeve*", pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", si *program i përbashkët studimi* midis Universitetit ZKM dhe Universitetit të Bolonjës, mbas diskutimeve me autoritetet shqiptare si edhe nisur nga intersi që paraqet sektori i turizimit në Shqipëri, programi u axhustua që të përshtatej me kete objektiv të rishikuar. Dhe me shkresë Nr. 558 date 31.07.2015, është bërë kërkesë pranë Drejtorise së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Programi i studimit nuk kaloi sërisht për akreditim hapje pasi bazuar në nenin *35* te Ligjit te Arsimit të Lartë ku cilësohet se kur ndryshimet në programet studimore nuk janë më shume se 20 % prograni nuk kalon sërisht për akreditim .

Riorganizimi është bërë me Urdher të MAS Nr.433, datë 12.11.2015 për *"Riorganizimin e programit të studimit të cilkit të dytë Master Profesional në "Ngritje dhe Zhvillim i Sipermarrjeve" në Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit"* midis Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Tiranë dhe Universitetit "Alma Mater" Bolonje.

Program ka filluar aktivitetin e tij në *shkurt 2016* bazuar në vendimin e rektorit Nr.78, date 25.01.2016, si pasojë e kërkesës së Universitetit partner për shtyrjen e fillimit të veprimtarise.

Në përfundim të studimeve një vjecare lëshohet *diplomë e përbashkët studimi* nga Universiteti i Bolonjës, si dhe nga Universiteti Katolik "Zoja e Keshillit të Mirë".

Progami master në sipërmarrje turizimi si *master unik* në Shqipëri, synon aftësimin e specialistëve dhe sipermarresve potenciale, me kompetenca të përgjithshme dhe specifike mbi ngritjen e biznesit dhe zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e Turizmit. Formimi i profesionistëve sipas kërtij synimi ka në fokus të tij që me njohuritë e ofruara ata të jenw te afte të analizojnë dhe të zgjidhin problematikat në situata komplekse, duke patur gjithmonë parasysh logjikën ekonomike dhe vizionin strategjik të institucioneve ku punojnësi edhe interesat e kulturën kombëtare.

## I. GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

KA dhe APAAL vendosën Prof. Shyqyri Llaci si ekspertë të jashtëm për këtë program studimi. GVJ është asistuar nga specialistja e APAAL Znj. .Xhiliola Bixheku

# RAPORTI GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Sikurse e theksuam edhe në pjesën hyrëse, Progami master në sipërmarrje turizimi si master unik në Shqipëri, synon:

- Aftësimin e specialstëve dhe sipermarrësit potenciale, me kompetenca të përgjithshme dhe specifike mbi ngritjen e biznesit dhe zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e Turizmit.
- Formimi i profesionistëve sipas kërtij synimi ka në fokus të tij që me njohuritë e ofruara ata të jenë të aftë të analizojnë dhe të zgjidhin problematikat në situata komplekse, duke patur gjithmonë parasysh logjikën ekonomike dhe vizionin strategjik të institucioneve ku punojnësi edhe interesat e kulturën kombëtare.
- Përgatija e specialsitëve me synim *të dyfishtë*; Përgatitje për tregun shqiptar dhe njëkohësisht pjesëmarrja e universitetit të Bolonjës në pjesën më të madhe të mësimdhënies dhe formimit të studentëve, të ofrojë shanse për punësimin e tyre edhe në BE në bazë të standardeve të larta të institucionit dhe specifikisht të programit master në sipërmarrje turizimi.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve[1] |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br><br>**Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;<br><br>**Kriteri 6** Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit. | **Kriteri 3** Po, ky program studimi është hartuar në pajtueshmëri me misionin dhe qëllimet e institucionit duke ofruar një program të përbashkët me një universitet prestigjioz sikurse është universiteti i Bolonjës.<br>Nga ana tjetër, ky program studimi përfaqëson realizimin e njërit prej objektivave të Marrëveshjes midis Kishës Katolike dhe Qeverisë Shqiptare (1993)-cka është në përuthje me qëllimet e sipërcituara.<br><br>**Kriteri 4** Porgrami është hartuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës, kjo është bërë mbas konsukltimeve me instituicione të speciazluara në vend që ta orientojne sipërmarrjen drejt turizmit.<br><br>**Kriteri 5** sipas dokumetacionit por edhe |

| | |
|---|---|
| | diskutimeve gjate visitës, rezulton se qëllimi i këtij program sipërmarrje në turizëm shkon në të njëjtin sens me synimet strategjike kombëtare për zhvillimin prioritar të degës së turizmit në Shqipëri<br><br>**Kriteri 6** Program Master në sipërmarrje turizimi, ka një qëllim të dyfishtë: është ngritur në përputhje me zhvillimet strategjike ekonomike të vendit por njëhersh duke mbrojtur dhe promovuar vlerave kulturore dhe turistike të Shqipërisë. Konceptimi i programit e ka pasur në vëmendje qysh në riorentimin e programit në mënyrë të specifikuar në degën e turizmit mbas edhe rekomandimeve të mara nga kontaktet me speciaslitë dhe institucione vendase. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; | **Krtieri 1**-Sikurse është cituredhe në kriterin 6 të mësipërm, fillimisht programi ishte orientuar në sipërmarrje por jo drejt turizimit. Duke u konsiultuar me institucione dhe specialste por edhe duke pasur në vemendje ngritjen e programeve bachelor, master dhe PhD në fushën e ekonomisë, kjo ka kompletuar edhe më mirë atë synim strategjik që nga krijimi i tij |
| **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. | **Kriteri 1 dhe 2**, Po programi i studimit është hartuar dhe funksionon në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Masteri Profesional në *"Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit"* është në përputhje me Kornizen Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe i përket nivelit të 7 (shtatë).<br>Ky master harmozion mirë kërkesa të legjislacionit tonë për hapjen dhe funksionimin e programeve të përbashkëta që finalizohen edhe me diplomë të përbashkët. |
| **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. | **Kriteri 1** Në rubrikat e mësipërme, u trajtua që institucioni në përmbajtje dhe në mënyrë eksplicite vepron në përputje me synimet e veta strategjike, por theksojme se plani strategjik tashmë nuk i parashikon ndryshimet dhe zhvillimet e kohës që analziojmë ndaj duhet të rifreskohet dhe plotësohet që ajo cka bëhet të jete e mirë dokumentuar |

| | |
|---|---|
| | **Kriteri 2** Sikurse u shprehëm edhe në kriterin e mësipërm 1, edhe këtu institucioni nuk ka një plan strategjik të mirëfilltë në fushën e përmirësimit të rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit, por e ka të shkrire këtë në strategjine e pergjithsme te institucionit |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br><br>Përgjithësisht mund të themi se institucioni ***i plotëson kriteret*** e kësaj rubrike, por sikurse e shprehëm, institucioni duhet të ripunojë dhe azhdornojë planin strategjik si për zhvillimin e programeve ashtu edhe të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit. Ndaj ky është edhe një rekomandim për instituciointin me qëllim që të mos jetë plotësim më një lloj rezeve në të ardhmen. | |

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit**

Parë në një kontekst të gjithë institucionit, vërejmë se UNZKM përbëhet nga 4 njësi kryesore/ fakultete pasqyuar në vendimin e senatit akademik (datë 26.01.2015 dhe me disa modifikime të pasqyrara në vendimin e rektorit nepermjet shkreses nr. 348 date 27.04.2015 )

Dhe konkretisht:

- Fakulteti i Mjekësise; Fakulteti i Farmacise; Fakulteti i Shkencave Ekonomike Politike dhe Sociale; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara.

Në këtë kontekst, Fakuteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale u strukturuan në përputje me legjislacionin (minimalisht 3 departamenet ose 2 departamenet dhe një qendër kërkimore);

- Departamenti i Shkencave Ekonomike dhe të Sipërmarrjeve;
- Departamenti i Strategjive Bioekonomike në BE dhe në Ballkan;
- Qëndra e Kërkimeve mbi ekonomine e Vendeve në Tranzicion.

Mbas kësaj, janë emëruar dekani dhe stafi i këtij fakulteti (dekreti/vendimi i rektorit date 05.11.2015) Vec shefave të departamenteve, fakulteti ka një organigramën e tij edhe koordinatorin e programeve të studimit i cili koordinon aktivitetin mësimor per cdo program studimi.

Programi master në sipërmarje turizimi, e ka filluar aktivitetin e tij në shkurt të vitit 2016, Kjo, sikurse pohohet në takimet e zhvlluara dhe e shpjeguar edhe në RVB, është e domosdoshme për shkak të marrëveshjes më universitetin e Bolonjë, i cili angazhon

pjesemarrje të madhe dhe efektive të pedagogeve italianë dhe *manaxhimi i kohës së lektorëve është i rëndësishëm.*

Nga verifikimet gjatë vizitës në institucion dhe e reflektuar drejt edhe ne RVB, rezulton se personeli akademik i programit të studimit formohet nga pedagogë italianë dhe pedagogë shqiptarë. Pedagogët italianë vijnë nga Universitetet partnere dhe përbëjnë mbi 2/3 të stafit të përgjithshëm akademik. Në master të sipërmarrje në turizëm *de facto* nga pala shqiptare, japin mësim vetëm 2 pedagoge- edhe ata janë me part –time (njëra është pedagoge e gjuhës angleze) Pjesa e stafit akademik në Shqiperi lidh kontratë bashkëpunimi me Fondacionin ndërsa marrëdhëniet me profesorët italian rregullohen me marrëveshje ndërinstitucionale.

Profesoret që lidhin kontrate me Fondacionin rekrutohen duke marra në konsideratë arsimimin dhe kualifikimin e tyre jashtë vendit dhe titujt që zotërojnë (profesor, profesor i asociuar, kërkues, doktor shkencash) kryesisht në Itali.

Pedagogët shqiptare lidhin me Universitetin kontrata të rregullta punësimi, të cilat hartohen nga Zyra Juridike dhe depozitohen pranë kësaj zyre dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Nëse vijojmë komentin më tej, do të theksonim se përzgjedhja e stafit akademik –***thuhet në RVB***- bëhet nëpërmjet një proçesi të hapur dhe transparent, por sikurse analizuam gjatë vizitës por edhe nga dokumentacioni, përzgjedhja e stafit të huaj procesi është i tillë , por ata vijnë pas marrëveshjes me Universitetin e Bolonjës dhe jo nga përzgjdhja këtu, cka reflektohej edhe në zyrën e personelit, ku nuk kishte dosje por vëtëm CV të pedagogëve të huaj.

Për pjesën tjetër të stafit (dmth shqiptar-dhe ky është 2 persona me part time në këtë preogram), pas shpalljes së vendeve të lira të punës ne web-sitin e Universitetit, aplikantet plotësojne në mënyrë elektronike në adresën përkatëse ose në formë të shkruar pranë Sekretarisë së Rektorit, sipas formatit të aplikimit të parapërcaktuar

Me tej eshte Zyra e Burimeve Njerëzore, që merret me procedurën e parashikuar, për ngritjen e komisionit përkatës të përzgjedhjes së kandidatëve, në përputhje të plotë me rregulloren e Universitetit. Përzgjedhja e pedagogëve me kontratë bëhet nga një komision i ngritur ad hoc. Është Rektori i Universitetit i cili emëron pedagogët me Vendim dhe më pas lidhet kontrata e punës. Kontrata dhe Dosja e Pedagogut depozitohen pranë Zyrës Juridike dhe Zyrës së Burimeve Njerëzore.

*Dosja e Pedagogut* përmban, - Bëhet fjalë për 2 pedagoge si pjesw stafit të programit të studimit që janë të angazhuar me part-time- ( materiale të cilat u verifikuan se ekzitojnë në zyrene personelit gjatë vizitës në institucion) ka të gjithë dokumentacionionin standard të kërkuar nga legjislacioni .

Ndërkohë që personeli akademik i huaj (italian) ka në dosje vetëm një cv, zyra e personelit, me përgjegjëste e re prej disa muajsh, synon plotësimin e dosjeve sipas këtij sandardi të mëlartëm, edhe për profesoratin e huaj. Kjo është një detyre që kërkon angazhim, por në këtë proces, kjo zyrë personeli ka mbështetjen e rektorit të univesitetit.

Personeli administrativ në mbështetje të aktiviteteve akademike përbëhet nga një staf, që lidhet me aspekte të ndryshme ndihmëse ndaj aktivitetit akademik: biblioteka, informatika, infrastruktura kryesore dhe mbështetëse, asistenca ndaj pedagogëve italianë në realizimin e misioneve të tyre, etj)–ku në RVB *vlerësohet "i gjerë"*, por nga diskutimet me drejtuesit shqiptare të institucionit u shpreh shqetësimi për një plotësim më të mirë të zyrave adminsitrative me staf pasi ka akoma nevojë për shtim stafi të kësaj kategorie.

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;<br>**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;<br>**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;<br>**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;<br>**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor". | **Kriteri 1**-Strukturimi i institucionit si edhe organizimi i tij në hallka dhe fakultetet e departamente është bërë në funksion të përmbushjes së misionit të tij.<br>**Kriteri 2**- Institucioni përbëhet nga katër Fakultete ndër të cilet edhe *Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale.*<br>**Kriteri 3 dhe 4** *Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale* ka në strukturën e tij dy departamenet dhe një qëndër kërkimore si edhe objektiva specifike të përcatuara për cdo nivel studimi<br>**Kriteri 5** Departamentete Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale, jane strukturuar me të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 me gradën shkencore "Doktor" duke përmbushur kërkesave ligjore për hapjen e departamenteve, |
| **Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. | **Kriteri 1-** Po njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve; për programine studimit master në sipëmarje turizimi ka coordinator program dhe secili department ka të qarta detyrat në procesin mësimor, shkencor dhe në përzgjedhjen e stafit sipas kritereve të specifikuara |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br><br>**Kriteret plotësohen të gjitha** si nga pikëpamja e numurit të fakulteteve , departameneteve të cdo fakulteti si edhe të përgjegjshmisë në përmbushjen e misioni. | |

**Theksojmë** se dosjete pedagogeve efektive janë të kompletuara ndersa pedagoget e huaj, kanë vetëm CV-ndaj është ***një detyrë*** plotësimi i dosjeve tyre pranë zyrës së personelit. Përzgjdhja e pedagogeve te huaj bëhët nga UB në bazë të marresvhjes me UNZKM

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

### Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Master porfesional në sipërmarje turizmi, sikurse edhe programete thera të studimit të të gjitha fakulteteve kanë më maxhorance absolute pedagoge nga universitete italiane. Ky program studimi master, duke funksionuar në bazë të marreveshjes me universitetin e Bolonjes- pedagoget i ka të përzgjedhur nga ky universitet Partner duke i dhënë prioritet atyre pedagogëve me tituj dhe me përvojën më të mirë në fushën e mësimdhënies.

Për të realizuar procesin e rekrutimi ka një komisioni të përbashkët përzgjedhës të Universitetit të Bolonjës dhe Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", që përzgjedh stafit mësimdhënës nga kritere të mirëpërcaktuara si titulli, grada, dhe përvoja profesionale në lëndën/lëndët që ofrohen në programin master.

Për pedagogët shqiptarë që bashkëpunojnë me pedagogët italianë diskutuam edhe në rubrikën paraardhëse (edhe në verifkimin e kritereve përkatëse) ndaj do përshkruajmë shkurt që përzgjedhja bëhet nëpërmjet konkursit që zhvillohet në UNZKM. Kriteret e konkurrimit, përzgjedhja e personelit, emërimi trajtohen në mënyrë transparente dhe kolegjiale nëpërmjet një komisioni përzgjedhës të emëruar nga Rektori.

I gjithë procesi është publik dhe konkurset publikohen në faqen web të Universitetit. E njëjta procedurë ndiqet edhe për personelin administrativ dhe ndihmës, në mënyrë që objektivi i cilësisë së personelit të jetë sa më i prekshëm dhe i dukshëm. Gjatë aktivitetit mësimor, stafi pedagogjik monitorohet në realizimin e saktë të procesit mësimor duke përfshirë në këtë proces stafin administrativ.

Personeli administrativ perbehet i teri nga staf i univeristetit dhe ndonëse në total në rang institucioni, raporti i stafit akademik me stafin administrativ anon dukshëm në favor të stafit administrativ, përsëri në takimet e bëra në institucion, dhe jo vetëm për këtë program studimi që analizojmë, që ky staf nuk është akoma i mjaftueshëm sa duhet, ndaj e shohin si një kërkesë të domosdoshme n të ardhmen e afërt.

Personeli akademik efektiv përbën mbi 80% të stafit të përgjithshëm akademik. Sikundër mund të vihet re edhe nga tabela 1 në aneks, lektorët janë me tituj, grada dhe eksperience të gjatë pune, duke ofruar një cilesi të lartë në mësimdhënie.

Ndërsa stafi administrativ është tërësisht shqiptar, stafi akademik brendshem është i përbërë nga profesorë të Universitetit partner dhe vetëm 2 janë nga stafi i Univeristetit KZKM- por edhe këta janë me part time dhe njëri është jo për lëndëprofesionale, por për gjuhën angleze.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | **Kriteri 1-** Në tërësinë e tij por edhe sipas strukturër, personel akademik, ndihmës mësimor -shkencor dhe adminsitrativ është i angazhuar dhe i motivuar dhe punon për aritjen e objektivave të programit të studimit<br><br>**Kriteri 2-** nëse analizojmë secilën pjesë të strukturës së realizimit të mësimdhënies, konstatojmë se në funksion të strategjisë së institucionit, këto hallka e kryejnë me cilësi detyrën:<br><br>a-*personeli mësimdhënës* – i përzgjedhur nga stafi italian është i përgjegjshem dhe i motivuar sipas lëndëve ku janë të kualifikuar dhe angazhuar<br><br>b-*logjistika* ku bejnë pjesë:<br><br>*1- Përgjegjesi i sallës se informatikës*<br><br>*2- administruesit e sallave mësimore*<br><br>janë përgjegjës dhe garantojmë respektivisht funksionimin e mësimdhenie në klasat/salla, kryerjen e provimeve të ndryshme si edhe organizimin e sallave sipas fakulteteve, numrit të studentëve etj.<br><br>3-*sekretaria* administron të dhënat e ndryshme për studentët gjatë gjithë kohës së studimeve<br><br>c-Vecojmë rolin e rëndësishëm të *Koordinatorit* të i programit të studimit që manaxhon relacionet e pjesës akademike shqiptare me atë italiane në të gjitha aspektet e procesit mësimor |
| **Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. | **Kriteri 1**- personeli akademik, në maxhorancë është nga universiteti i Bolonjës, i cili edhe luan rolin kryesor në hartimin dhe realizimin e kurrikules. Theksojme se roli i pales shqiptare ka qene i rendeishem ne fazën e orientimit të këtij programi në sipermarrje te specifikuar *në turizëm*.<br><br>**Kriteri 2**- Po, rekrutimi i personelit e theksuam tek pjesa pershkruese dhe në rubrikën paraadhëse të saj, që procesi është transparent dhe me komision të përbashkët të dy univesriteve parnere në bazë të kritereve si grada, titulli e eksperienca. Në perzgjedhje zbatohen procedurat ligjore si edhe nenet e marrveshjes me universitetin e Blononjës (për pedagoget italiane). Ngarkesa ka në bazë në shperndarje aktet nënligjore te specifikuara |
| **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj. | **Kriteri 1** – Po institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>Kriteret e konkurrimit, përzgjedhja e personelit, emërimi trajtohen në mënyrë transparente dhe kolegjiale nëpërmjet një komisioni përzgjedhës të emëruar nga Rektori.<br><br>I gjithë procesi është publik dhe konkurset publikohen në faqen web të Universitetit. E njëjta procedurë ndiqet edhe për personelin administrativ dhe ndihmës<br><br>Nëse vijijmë komentin më tej, do të theksonim se përzgjedhja e stafit akademik –***thuhet në RVB***- bëhet nëpërmjet një proçesi të hapur dhe transparent, por sikurse analizuam gjatë vizitës por edhe nga dokumentacioni, përzgjedhja e stafit të huaj nuk bëhet në këtë formë pasi ata vijnë pas marrëveshjes me Universitetin e Bolonjës cka reflektohej edhe në zyrën e personelit, ku nuk kishte dosje por vetem CV të pedagogëve të huaj.<br><br>**Kriteri 2**- Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programein master në sipërmarrje turizmi është mbi 80% dhe tëreësisht staf iltalian; stafi shqiptar përbëhet vetëm nga dy pedagoge me part time. Ndoshta ka vend për shtesë stafi shqiptar sidomos në seminrate praktikë për realitetin e turizmit vendas ku lektorët e huaj kanë mangësi njohje. |
| **Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;<br>**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br>**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;<br>**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;<br>**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. | **Kriteri 1-** përgjegjësi i programit e përmbush kriterin- ka Profesor i asociuar të fituar në universitetet e huaja (italiane)<br><br>**Kriteri 2** –Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi,<br><br>**Kriteri 3-** Kriteri plotësohet teresisht-titullaret jane pdagoge italiane me grade doktor dhe me tituj pedagogjike si edhe me përvojë të gjatë mbi 5 vjetë në profesion.<br><br>**Kriteri 4-** Po, të gjithë drejtuesit duke filluar nga rektori e deri tek përgjegjësi i programit –jane të punësuar me kohë të plotë<br><br>**Kriteri 5** - Po Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Aq me tepër që numri I studneteve është miminal 6 studente- dhe praktika e tyre një javore është realizuar në Rimini, Itali |
| **Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.** | |
| **Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;<br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";<br>**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. | **Kriteri 1-** Çdo student ka një udhëheqes. E vecanta e temës së diplomës është se cdonjeri prej studenteve do te pergatisi nje projekt individual per ngritjen e nje *Sipermarrjeje* duke nderthurur njohurite teorike te pervetesuara me aspektin praktik profesional- cka garantohet me tej edhe nga udhehqesi<br><br>**Kriteri 2-** Po, udheheqesit kanë graden dokor e lart dhe eksperinece nw profesion cka garanton nje mbikqyrje profesionale te temes diplomes.<br>Cdo student do te kete nje udheheqes gjate fazes<br><br>**Kriteri 3-** Cdo udheheqes/mbikyres ka 1 student- çka e lehteson edhe numri total i studenteve te programit që është shumë i vogel (6 studente) |
| **Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.** | |
| **Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.<br>**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. | **Kriteri 1-** Që në momentin e perzgjdhjes së stafit kërkohet që fusha e specializimit te jete ne perputhje me lendet që do mbuloje. Një kriter i tillë aplikohet edhe ne perzgjedhjen e temës së studentit që ti përshtatet fushës kërkimore e studmore te pedagogut udheheqes<br><br>**Kriteri 2-** Po, pedagoget sikurse eshte cituar edhe ne rubrika pershkruese, jane perzgjdhur me tituj, grada dhe eksperiencene mesimdhenie dhe kerkimin shkencor-ndaj edhe perzgjedhja e tezes se diplomes eshte ne kete kah |
| | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | **Kriteri 1 dhe 2** – sikurse e cilësuam edhe ne krteret e standardit II.1 i gjithe stafi pedagogjik i instituciomnit, ai ndihmës dhe dhe stafi administrativ janë të angazhuar sipas fushave që mbulojnë si përgjegjesi i informatik, adminstratori i sallave, sekretaria etj punojne per për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore me efience duke ndihmuar dukshem në përmbushur objektivat e parashikuara nga programet e studimit të këtij masteri dhe në programet e tjera te studimit te fushes ekonomike. |
| **Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.** | |
| **Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;<br><br>**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore. | **Kriteri 1-** sikurse eshte pershkruar edhe tek RVB, por edhe sipas pyetjeve ne viziten ne institucion rezulton se personeli kademik e realizon ngarkesën mësimore në përputhje me ate te universitetit partner italiane dhe parimet e ndarjes janë të përcaktuara në marrëveshjen e bashkepunimit përkatëse.<br>Pedagogët italiane kane ngarkese edhe ne Universitetin e Bolonjës edhe ketu ne Shqiperi-pra, i bie te jete ngarkese e dyfishte.<br>**Kriteri 2-** ngarkesa mësimore e personelit akademik realizohet ne ore mesimore ne audtor dhe pune e pavarur jashte auditorit sikurse operohet edhe neuniversitetet ve tjera te vendit |
| **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. | **Kriteri 1dhe 2** institucioni ka bazën e të dhenave në zyrën e personelit si edhe tek Zyra e Koordinatoreve të programit të studimit<br><br>Zyra e personeli ka te dhena me te plota, por dosjet e pedagogeve italiane bazohen kryesosht ne Cv e tyre.<br><br>Institcioni ka Listë të plotë të personeli per cdo semseter (akademik, ndihmes dhe administrativ)<br><br>Zyra e personeli diponon te dhena te plota per stafin ndihmes mesimor dhe administrativ<br><br>**Kriteri 3-** E kemi pershkuar edhe ne rubrika te tjera qe institucioni ndjek një politikë të hapur transparente rekrutimi dhe punësimi të personelit akademik dhe stafit administrativ nëpërmjet shpalljes së konkurseve publike për vendet vakante në faqen web-it te universitetit.<br><br>Rekrutimi ndjek procedura standarde të përshrkuara në rregulloren e brendshme dhe zbaton legjilsalcionin dhe marreveshjen e nenshkruar me universitetin e Bolonjës |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Kriteret e kesaj rubrike ***përgjithësisht konsiderohet të plotësuara*** si per shkak te angazhimit me efektivitet te stafit drejtues, por edhe te stafit pedagogjik qe mbi 80% eshte i universitetit te Bolonjës.

Keshilli shkencor i programit eshte i perzgjedhur nje prof italian dhe nje shqiptar me tituj dhe grada shkencore dhe pervoje te gjate me punen ne universitet dhe drejtim. Koordinatoja eshte PhD studnet me background nga universitet italian –cka ben te mundur nje ure lidhje me te mire per te rritur cilësin në komunikim dhe realizimin e programit.

Perzgjedhja e stafit eshte me kritere rigoroze dhe trasparent dhe bazohet legjislacion dhe ne marrveshjen e bashkepunimit me universitetin e Bolonjës. Duhet të kompletohen te dhenat e stafit italian ne zyrene personelit si edhe stafi ndihmës të jetë mëi madh për të kompletuar me mire zyrat per adminstrim akoma me eficent te gjitha hallakve te procesit mesimor.

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, ndodhet në Rrugën "Dritan Hoxha", Tiranë, prej vitit 2004. Ambjentet në shfrytëzim nga ky Universitet, kanë një siperfaqe totale prej 50.400 m2 dhe janë në pronësi të Fondacioni Themelues "Zoja e Këshillit të Mirë".

Objekti ku zhvillojnë mësim studentët e ekonomisë është një ndërtesë trekatëshe sipërfaqja e së cilës është 5295 m2 e ndarë në tre kate me nga 1765 m2 për secilin kat.
Infrastuktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor, plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë.
Sipas RVB dhe konstatimeve në institucion gjatë vizitës dy ditore, godina ku zhvillohet kryesisht procesi i mësimdhënies së programit të studimit Master në *"Ngritje dhe Zhvillim i Sipermarrjes ne Sektorin e Turizmit"*, i quajtur *"Casa Rossa"*, është ndërtim njëkatësh i ri me strukturë të parapregatitur prej druri - funksionale dhe estetike, larg zonës industriale dhe zhurmave.
Godina i plotëson të gjitha kushtet për zhvillimin normal të aktivitetit të procesit mësimor. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me PC dhe videoprojektor, disponojnë rrjet informatik, ëi-fi falas, plotësojnë normat teknike të ndriçimit, janë të pajisur me sistem ngrohjeje si dhe sistem sigurie kundër zjarrit etj. Gjithashtu, ndërtesa i plotëson normativat e sipërfaqes së shfrytëzuar $m^2$/për student.
Instituconi vë në dispozicion të studentëve të këtij programi literaturë cilësore dhe të mjaftueshme. Por biblioteka *nuk ofron akses ne literature shqip* dhe nuk ka *pothuajse asnje kopje reviste apo libri mbi ekonomine, spermarrjen dhe turizimin te studjuesve shqiptare apo ne gjuhen shqipe*

Pjese e infrastrukturës janë mjediset shlodhëse si mjediset sportive, kafeteria si dhe shërbimi i mensës e cila parashikon cmime të reduktuara për studentët.
Godinat janë të rrethuara nga mure mbrojtëse, të cilat japin idenë e një kampusi të madh, gjë që lehtëson lëvizjen e studentëve nga një ambjent te tjetri

Universitetit ka vënë në dispozicion të studentëve të të gjitha kurseve një sallë Interneti me kapacitet përkatësisht 24 kompjutera Desktop (Cassa Rossa) dhe një laborator informatike me 48 kompjutera Laptop (Godina Qëndrore). Të dy sallat janë të pajisura me internet të dedikuar 40 Mbps.
Sallat janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orarit të mësimit: Struktura parashikon prezencën e Sallës së Bibliotekës, ambienti i cili ka sipërfaqe prej 458 m2
Për lehtësi të anës logjistike, institucioni disponon një parkim të mjaftueshme në funksion të studentëve dhe personelit administrativ.

*Laboratorët e Informatikës*

*Institucioni u ofron* studentëve të të gjitha kurseve 1 sallë interneti me kapacitet përkatësisht 24 kompjutera Desktop (Cassa Rossa) dhe 1 laboratorë informatike me 48 kompjutera Laptop (Godina Qëndrore). Të dy sallat janë të pajisura me internet të dedikuar 40 Mbps.

Sallat janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orarit të mësimit: Studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat për të naviguar në internet, kryer kërkime apo përdorur shërbimet e tjera të shkollës (biblioteka, portali, materialet mësimore etj). Të njëjtat shërbime ofrohen edhe përmes rrjetit Ëireless falas me kapacitet 70 Mbps, nëse studentët kanë pajisjet personale për te përdorur (smartphone, laptop etj.) sipas parimit BYOD (Bring Your Oën Device).

Salla me 24 kompjutera Desktop është ngritur si termainal Server mbi *Linux Open Source,* dhe gjithashtu ofron një hapësirë për te përdorur shërbimet Ëindoës dhe Office si Terminal i një serveri të dedikuar vetëm për këtë laborator.

Salla me 48 Laptop është e pajisur me 48 Laptop Acer 3 dhe gjithashtu përdor një Server të dedikuar për shërbimin Terminal. Ky shërbim përdoret kryesisht për te zhvilluar provime të ndryshme në formë elektronike (jo vetëm te lëndës së informatikës).

*Përshkrimi Bibliotekës sipas standarteve*

Në funksion të përmbushjes së kërkesave të studentëve, stafit pedagogjik si edhe përdoruesve te tjere te universitetit, i biblioteka ofron një literaturë adekuate. Ka në zotërim të saj tekste të mjaftueshme duke synuar përhërë shtimine fondit si edhe updatimin e tij.
Biblioteka, në mbështetje të kërkimit të periodikëve online iu ofron studentëve shërbimin e Document- Delivery, shërbim i cili bën të mundur gjetjen e artikullit me gjithë full-tekstin e tij, në rastet kur vetë biblioteka nuk e zotëron atë. Ky shërbim arrihet nëpërmjet bashkëpunimit me bibliotekat homologe në Romë e Milano.

Nga vizitia dhe spjegimiet e dhëna në takime u konstatua se biblioteka funksionon edhe si një librari elektronike e cila përmban në vetvete dy data base burimesh elektronike, por edhe anetaresimi ne *Projektin Hinari*, ku stafi dhe studnetët njihen me zhvillimet në disa fusha, përfshire edhe ate te ekonomise e turizmit. Ka mbi 150 partner publikues, te cilet ofrojne me shume se 15.000 burim informative per Hinari-n, periodik on line e 47.000 libra e-book.

Kërkedsat e pedagogeve të lëndëve si edhe të studentëve merren ne konsiderate kur shtohet dhe përditesohet fondi ekzistues. Për cdo vit akademik ka një buxhet të hapur, në përmbushje të kërkesave.

Sa i perket numri te librave qe nje student do te huazoje, nuk ka limite, por biblioteka online mund te shfrytezohet vetem ne universitet dhe jo ne biblioteka e tjera apo nga shtepia. Në bibliotekë ofrohet sherbimi free ËI-FI si dhe sherbimin e blerjes se librave per studentet qe interesohen ti kene personale tekstet e tyre.

Biblioteka eshte ne dispozicion te perdoruesve te saj cdo dite nga e hena ne te shtune ne oraret 08.00-21.00.

Ky fond ne hard copy dhe sidomos online si edhe kushtete ofruara e bëjnë mjaft konkurruese kete bibioteke, por *ka nje mangesi* qe periodike apo libra, *studime ne shqip nuk ka;ky sherbim nuk ofrohet as online.*

*Mjediset e UniKZKM*

Nga materialet e vëna në dispozicion nga universteti ekzitojnë të dhënat e përshkruara në tabelën 1(Nga RVB) mbi sallat e mësimit, laboratorët e informatikës, mjediset e logjistikes, mjediset clodhese , zyrat dekanin, për sekretarinë etj, cka ndodhen edhe në RVB ku janë dhene pa ndryshime nga ato që disponuam gjatë vizitës në terren. Pra, eshte e njejtja tabele sikurse e paraqesim ne raport ne vijim,

Tabela1

| Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit | Sasia | Sipërfaqja |
|---|---|---|
| Salla për leksione, Seminare | 1 | 71.5 $m^2$ |
| Salla për aktivitete promovuese | 1 | 319 $m^2$ |
| Laboratorë informatike | 1 | 83.2 $m^2$ |
| Salla interneti/ Ëi- Fi free | 1 | 71.5 $m^2$ |
| Salla për bibliotekë, librari | 1 | 458 $m^2$ |
| Mjedis për fotokopjime etj | 1 | 50$m^2$ |

| | | |
|---|---|---|
| Zyrë informacioni për studentët | 1 | 31.2m² |
| Korridore/holle | 3 | 891.3m² |
| Mjedise sportive | 1 | 680 m² |
| Mjedise shërbimi për të tretë | 1 | 95.5 m² |
| Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 1 | 21m² |
| Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | 1 | 93.3 m² |
| Nyje hidrosanitare për studentët + personave me aftesi te kufizuara. | 22 | 68.6 m² |
| Kuzhina | 1 | 97.4 m² |
| Mensa | 1 | 275.9 m² |
| Lulishtja | 1 | 41.788 m² |
| Parkim | 1 | 9888.92m² |
| Norma m²/për student | 181.9 m² | |

| Mjediset për stafin: | **Sasia** | **Sipërfaqja** |
|---|---|---|
| Dekani/ Drejtori i Pergjithshem/Sekretari i Pergjithshem/Koordinator | 5 | 138 m² |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 1 | 22 m² |
| Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore | 1 | 80 m² |
| Zyra e koordinatorit | 1 | 22 m² |
| Zyrë për financën | 2 | 37.3m² |
| Zyrë për Njësinë e SBC | 1 | 21.2 m² |
| Salla për mbledhje | 1 | 40.4m² |
| Mjedis për stafin e shërbimit | 3 | 78.5 m² |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 11 | 39.6 |
| **Norma m²/për person** | **18.3 m²** | |

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardi/Kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve** |
|---|---|
| **Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;<br><br>**Kriteri 2** Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;<br><br>**Kriteri 3** Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj. | **Kriteri 1** - sikurse e cituam edhe tek pjesa pershkruese, UZKM, ndodhet në Rrugën "Dritan Hoxha", Tiranë, prej 12 vitesh. Ambjentet në shfrytëzim nga ky Universitet, kanë një siperfaqe totale prej 50.400 m2 dhe janë në pronësi të Fondacioni Themelues "Zoja e Këshillit të Mirë". Objekti ku zhvillojnë mësim studentët e ekonomisë është një ndërtesë trekatëshe sipërfaqja e së cilës është 5295 m2 e ndarë në tre kate me nga 1765 m2 për secilin kat<br><br>**Kriteri 2**- këto mjedise janë në pronësi të institucionit prej vitit 2004<br><br>**Kriteri 3**- Program master në sipermarrje ne turizëm ka një godinën *"Casa Rossa"*, është ndërtim njëkatësh i ri me standarde moderne dhe garanton arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve master që analizojm1<br><br>**Kriteri 4**- Nuk ofrohet paktike për këtë program studimi, ndaj dhe mjediset nuk jane të nevojshme. E vetmja praktë një javore behet nën kujdesin e Ubolonjës -Itali |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;<br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;<br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;<br>**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve. | **Kriteri 1**-Institucioni ka një biblioteke, e cila ofron fond te mjaftueshem ne hard copy dhe elektronik, ne gjuhen italiane sipas standardeve qe perdor edhe universiteti i Bolonjës<br><br>**Kriteri 2**- Biblioteka ka fond te bollshem, i cili axhornohet dhe updtohet cdo vit ne baze te kerkesave te studenteve dhe lektoreve.<br><br>**Kriteri 3**- Biblioteka ka libra dhe periodike, por vecanesisht e pasur eshte bibioteka online, te cilet e kemi dhene te detajuar ne pjesen pershkruese Studentet marrin nga bibioteka edhe literaturen e nevojshme per projektet e kursit. Por nuk ka litetrature ne gjuhen shqipe cka eshte e nevojshme per pergatitjen e tyre edhe me mire per praktiken e biznesit te turizmit ne vendin tone.<br><br>**Kriteri 4**-Po, ka një plan për shtim dhe rifresimim e pervitshem te fodnit ne baze të kërkesave qe cituam ne kriterin 2. Ky plan mbeshtetet nga nje buxhet i pervitshem, i cili mendojme se duhet te zgjerohet qe te perfshije edhe libra e periodike ne gjuhen shqipe<br>**Kriteri 5**-Po, biblioteka eshte e hapur cdo dite nga e hena – shtune ne orar 8-21.00.00 |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të | **Kriteri 1**- tek pjesa pershkrusese (dhe tek tabela 1 ) kemi të dhëna mbi logjistiken infrastrukturore, cka jane mësete mjaftushme per nje mesim normal, me pasije teknologjise se informacionit si edhe mjedise komode zyrash-te gjitha s bashku garanojne mbshtetejne per reealizimin me sukses te programit te studimit master ne turizem. |

| | |
|---|---|
| përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;<br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike. | **Kriteri2-3 dhe 4** Po, pajisja e mjedisve eshte e pershtatshme me mjetet e duhuar dhe cilesore- mjafton te permendim se institucioni ofron 1 sallë interneti me kapacitet përkatësisht 24 kompjutera Desktop (Cassa Rossa) dhe 1 laboratorë informatike me 48 kompjutera Laptop (Godina Qëndrore). Të dy sallat janë të pajisura me internet të dedikuar 40 Mbps.<br><br>Gjatë vizites në ambientet e UNIZKM, u konstatua se salla e informatikës ishte e pajisur me 48 Laptop Acer i3, dhe gjithashtu përdor një Server të dedikuar për shërbimin Terminal.<br><br>Ky shërbim përdoret kryesisht për te zhvilluar provime të ndryshme në formë elektronike (jo vetëm te lëndës së informatikës).<br><br>Per me shume detaje referohuni pjeses pershkimore. Nga ana tjeter, kemi te bejme me nje grup komod me 6 vete ku sallat dhe pasjiet jane shume me te pajisura dhe me hapesiar se sa madhesia e ketij kursi |
| **Konkluzionet e vlerësimit:**<br><br>**Kriteret plotesohen te gjitha dhe në mënyrë cilësore.** E vetmja vrejtje eshte qe biblioteka duhet te pajiset edhe me libra dhe periodike shqip qe studentet te kene mundesi qe te aplikojne me mire në terrenin e biznesit të turizmit në Shqipëri, njohurite qe marrin. Edhe biblioteka online nuk ofron akses ne literaturen shqip. Ndaj dhe fondi i parashikuar ne buxhet per axhornim dhe perditesim, duhet te shtohet edhe per efekt te ketij elementi | |

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në dy vitet e fundit paraqiten si ne vijim. Gjendja financiare e institucionit sikurse rezulton nga kontaktet gjate vizites por edhe nga dokumentacion i ofruar eshte e mire. Por po ti referohemi tabelës 2 (e cila pasqyron drejt 'gjendjen e te ardhurave - dhe eshte e paraqitur edhe nga RVB si table me nr 8 ) duket se te ardhurat jane teresisht nga tarifat e shkollimit.

Pra, te ardhura nga aktivitetet kerkimore dhe sherbime nga te tretet nuk ka, cka evidenton edhe mangesi te kerkimit dhe angazhimit ne aktivitete biznesi dhe te tjera. Dhe janë të pamjaftushme për të mbuluar kostot psh te programit master ne sipermarrje turizimi

Tabela 2

| Të ardhurat nga: | Viti 1 | Viti 2 |
|---|---|---|
| Pushteti qendror | | |
| Pushteti vendor | | |

| | | |
|---|---|---|
| Fonde jopublike: | | |
| Grantet për kërkim dhe kontratat | | |
| Konsulencat, shërbimet | | |
| Tarifat për dhe gjatë shkollimit | 1.890.000 | 9.450.000 |
| Sponsorizimet | | |
| Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) | | |
| Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj | | |
| Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) | | |
| Gjithsej | | |
| Shuma (leke) | | |

Në vitin e dyte kemi ulje të të ardhuarve nga tarifat, pasi nr i studenteve zbriti nga 30 te parashikuar ne 6 studente. Kjo eshte argumetuar me vonesen ne hapjen e programit te studimit per shak te burokracisë në komunikimin me MAS. Vonesa ne hapje solli edhe fluks te vogel te studenteve, pasi viti shkollor akademik kishte disa muaj qe kishte filluar ne gjithe vendin.

Në institucion funksionon edhe Fondacioni, të ardhurat e të cilit vihen në dispozicion të studentve, përfituesve të shërbimeve dhe konkretizohen në struktura bashkëkohore, mjete, knoë-hoë si dhe rezerva për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve.

Nga bisedat me drejtues te institucionit, verehej nje kerkese që fondacioni te shtojë më shumë kontributin e tij financiar edhe për shkak te ardhurave të pakta nga tarifat, apo nga angazhimi jo i madh në kërkim dhe sherbime ndaj te treteve.

Në tabelen në vijim është kosto e kalkuluar për student, ku ndërsa shpenzimet janë rritur në total, të ardhuar të referuara tabeles 2 janë rritur në total

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

| Viti | Shpenzime | Kosto/Student |
|---|---|---|
| Viti (2015-16) | 1.260.000 | 210.000 |
| Viti (2016-17) | 3.150.000 | 210.000 |

Edhe në tablën e shpenzimeve të paraqitura nga RVB, të dhënat janë të sakta dhe të verifikuara gjatë diskutimeve në institucion. Kostot shtesë për programin e studimit nga mosarkëtimeve i shumës së parashikuar nga tarifat e shkollimit janë mbuluar nga të ardhurat e fonacionit të UNZKM.

Nuk ka gjithashtu, as grante te perftuara vec atyre nga Fodacioni, nderkohë që është bërë një aplikim për projekt kerkimor 2 vjecar pranë USAID dhe akoma është në proces dhe nuk eështë marë përgjigje mbi pranimin ose jo të tij.[2]

***Manaxhimi financiar.*** Në pasqyrën financiare të univeritetit për 2015, përmblidhet me zëra i gjithë aktiviteti i të ardhurave dhe shpenzimeve. Gjithashtu, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është një OJF për këtë arsye nuk paguan tatim mbi të ardhurat. Gjithashtu, nuk ka të detyrushme as auditim të jashëtm por realizon auditimi dhe kontroll të brendshëm.

Po kështu, edhe fondacioni Fondacioni, nisur nga forma ligjore si OJF, dhe bazuar në aftësitë menaxhuese financiare të tij, dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe synon në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbim-dhënies.

**Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet.** Në lidhje me këtë ceshtje, po citojmë RVB "Pasqyrat financiare paraqesin situatën financiare për vit ushtrimor ku, si rregull i brëndshëm i institucionit, viti ushtrimor përkon me vitin mbyllës të vitit akademik. P.sh., viti ushtrimor 2014 përkon me vitin akademik 2013-14" .

Institucioni, bazuar në kërkesat ligjore, bën auditimin e brendshëm. Pasi është kryer ky i fundit, dhe pasi janë miratuar nga Këshilli i administrimit, pasqyrat financiare dërgohen tek organet kompetente. Kjo procedure e cituar në RVB, realizohet edhe në fakt, sikurse evidentohet edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit disponibël ( Pasqyra financiare e vitit 2015 )[3]

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.** | |

[2] Nga sqarime të dhëna gjatë kontakteve në vizitën 2 ditore ne institucion na është dhënë ky shpjegim: Fondacioni "Zoja e Keshillit te Mire" eshte i rregjistruar prane zyres se *Regjistrirmit te OJF-ve*. Nderkohe *Univeristeti Katolik "Zoja e Keshillit te Mire"* eshte nje aktivitet i Fondacionit themelues. Sa i perket shumave te tjera te te fituara nga te tretet vetem ne raportin Fondacion - Universitet (pasi fondacioni ka dhe aktivitete te tjera pervec Universiteti si psh eshte Poliklinika At Luigji Monti) jane taksat e studenteve.

[3] Kemi konstatura ate cka thone pasqyrat financiare, por jo nje pershkrim te perfundimeve te auditit te brendshem, I cili duhet te jete i dokumentuar me shkrim

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 3** Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh. | **Kriteri 1-** po, pasqyrat financiare paraqesin gjithe situatën financiare mbi përdorimin e buxhetit të alokuar për programet e studimit.<br>Institucioni kryen auditim të brendsshëm vjetor dhe tremujor. Auditimi vjetor bën certifikimin vjetor (te asaj cka pasqyrohet ne vjueshmërinë e auditeve periodike tremujore.) të informacionit financiar sipas kompetencave dhe kerkesave ligjore. Por material i shkruar nuk na u paraqit, vecse konstatimet nga pasqyrat financiare dhe diskutimet gjate vizites ne institucion<br><br>**Kriteri 2-** për vitin të cilin analizojmë, nuk ka grante të specifikuara<br><br>**Kriteri 3** - nga bisedat dhe RVB theksohet se auditi analizon eficencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat në lidhje me kurset e vecanta të studimit. (por me mangesine e kriterit 1)<br>Vërejmë se në këtë vit akademik, të ardhurat nga tarifa nuk kanë qënë të mjaftueshme për shkak të numrit të vogël tye studneteve, dhe kostot janë mbuluar nga të ardhurat e fondacionit |
| **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. | **Kriteri 1-** Nga konstatimet rezulton se Institucioni ka zyre dhe personel te specializiuar që përpilojnë raport me të dhëna financiare analitike për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.<br><br>**Kriteri 2-** Nga "leximi" i pasqyrave financiare të Institucionit, dëshmohet qëndrueshmëri financiare në tërësi dhe për mbulimin e aspekteve financiare edhe të Programit master ne sipermarrje turizimi, ndoëse ky si program nuk eshtë kosto eficent sepse nuk mbulon shpenzimet. Institucioni i mbulon shpenzimet nga burime te tjera te brendshme, sikurse janë programet e tjera që janë eficente nga pikëpapmja e mbulimit dhe të shpenzimeve apo fondacioni |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

***Në tërësi, kriterer e kësaj rubrike konsiderojmë të plotësuara, por me rezerve.*** Institucioni kryen auditim të brendsshëm vjetor dhe tremujor, por nuk disponuam raport te auditit. Gjendja financiare paraqitet e qendrueshme. Ne rastet kur nuk mbulohen kostot, sikurse eshte dhe programi Master në sipërmarrje turzimi, është fondacioni që operon si OJF qe i mbulon këto kosto. Theksojme se burimi kryesor i të ardhurave janë tarifat e studenteve. Nuk përftohen të ardhura nga shërbime ndaj të tretëve apo nga angazhime ne projekte kerkimore. Këto dhe zëra të tjerë të kësaj natyre, janë burim i rëndësishëm të ardhurash ndaj synimi duhet tëketë që në të ardhmen të garantiohen me shume të ardhura nga këto burime që duhet të jenë objektiv i universitetit.

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

<u>**Pjesa përshkrimore**</u>

Pranë UNZKM është ngritur dhe funksionon zyra e sigurimt të cilësisë (tablela 5) me 7 anëtarë duike filluar nga data 15.09.2015.

Sigurimi i Cilësisë në Universitetin KZKM realizohet në disa forma. Sipas RVB dhe takimit me titullarë të institucionit, theksohet se aplikohen të njëjtat mekanizma të sigurimit të cilësisë që përdoren edhe në Universitetet Italiane partnere, me të cilat ofrohen programet e përbashkëta të studimit. Dhe fillesa e këtij mekanizmi daton që në vitin akademik 2004-2005.

*Forma kryesore* eshte vlerësimi realizohet nëpërmjet pyetesorëve me studentet, për të gjitha programet e studimit dhe çdo lëndë. Pyetesori përmban pyetje mbi për cilësinë e organizimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, metodologjitë e mësimdhenies, infrastrukturën, angazhimin e stafit akademik, literaturen e përdorur etj.

Plotësimi pyetësoreve bëhet online *duke filluar nga ky vit që analizojmë* dhe cilësohet si një risi dhe është e njejta mënyrë që realizohet edhe në universitetin e Bolonjës. Anketimi kryhet pas përfundimit të mësimdhënies së çdo lënde dhe përpara zhvillimit te provimit dhe është anonim.

Rezultatet e pyetësoreve nga Njesia e Sigurimit të Cilësise shqyrtohen nga Rektorati, dhe më tej i përcillen Komiteteve të Përbashkëta Teknike me Universitetet Italiane partnere si dhe stafit akademik të programit të studimit.

Duke pasur informacion të mjaftueshem nga përpunimi të dhënave bazë, Komitetet e Përbashkëta Teknike zhvillojnë mbledhje të përvitshme ku mbas analizimit të ecurise, marrin edhe vendimet respektive për elemenimin e defekteve te vrejtura. Kjo analizë është në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimedhenies apo aspekte të tjera që mbulon ky vlerësim cilësie.

*Formë tjetër* është e vlerësimit të cilësisë dhe që është e manaxhuar nga koordinatoret e programeve përkatës të studimit, është edhe zhvillimi i mbledhjeve mujore me studentet e çdo programi studimi- me studentë të gjitha viteve. Në këto mbledhjet peroidike, shpesh marrin pjesë edhe përfaqesues të Rektoratit, gjë që bën që bën të mundur që organet eprore e marrin informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë

Theksojmë se *nuk bëhet vleresim me shkrim nga përgjegjësi i departamentit* - por të dhënat nxirren nga pyetesori i studenteve ku janë të përfshira pyetjet respektive. Për rrjedhoje as zyra e personelit *nuk e disponon* një vlerësim të tillë (Sikurse kemi pohuar, ne zyren e personelit deri ne keto momente, ne dosje eshte vetem Cv e pedagogeve italiane dhe dosje te plota vetem per dy pedagoget shqipare qe ajne me part time)

Ky vlerësim është analog sikurse pohojne ne takimet që zhvlluam ne institucion, me atë lloj vleresimi që bën edhe universiteti partner. Ndoshta do te ishte mire qe vleresimi te behet edhe ne nje format tjeter, me shkrim dhe i evidentuar me vete, duke marre te dhena te pyetesorit (qe eshte nga studentet) por edhe nga mbikqyrja e eprorit – ne kete rast e pergjegjesit te departamentit apo dekani. Kjo do ta kompletonte vleresimin e cilesisë e se mesimdhenies dhe do ishte akoma me objektiv, sidomos ne rastin konkret të këtij masteri,

ku edhe nr i studenteve eshte sh i vogel (6 anketa gjithsej-aq sa eshte edhe numri i studenteve)

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.<br><br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;<br>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;<br>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;<br>h. Etj. | UNZKM ka filluar aplikimin e metodologjise se vleresimit dhe instrumetat mates se cilësisë që përdorein edhe universitetet partnere (Fillimisht universiteti i Barit e deri sot tek Universiteti i Bolonjës). Kjo traditë zë fill që në vitin akademik 2004-2005,.<br>Eshtë e ngritur dhe funksionon zyra e sigurimit të cilësis me 7 anëtarë që prej shtatorit t vitit 2015.<br><br>Janë disa forma të vlerësimit të cilësisë<br><br>**a**-*Forma e parë* dhe më kruciale janë *pyetesorët me studentet,* për të gjitha programet e studimit dhe çdo lëndë.<br><br>Pyetesori përmban pyetje mbi cilësinë e organizimit dhe zhvillimit të orës së mësimit metodologjitë e mësimdhenies, infrastrukturën, angazhimin e stafit akademik, literaturen e përdorur etj, pra, përmban edhe elemnete te përbajtjes, por edhe të formës apo të logjistikes ejt<br><br>Plotësimi pyetësoreve bëhet *online*. Këtë vit aplikohet per here te pare dhe eshte sipas standardit të universitetit të Bolonjës<br><br>Realizimi anonim i pyetesoreve si edhe koha e kryerjes para provimit dhe përpunimi I tyre mbas provimit, ben që të rritet shkalla e objektivitetit.<br><br>**b** - *forma e dyte* jane zhvillimi i mbledhjeve mujore me studentet e çdo programi studimi-me studentë të gjitha viteve. Këtu marrin pjese shpesh edhe perfaqesuestë rektoratit. Ndërsa e para eshte forme e therthorte, kjo e dyta eshte forme e drejperdrejte, e shpejte dhe informacioni shkon drejperdrejte tek organet drejtuese te universitetit.<br><br>Me mbledhjen dhe analizimin statistikor të të dhënave publikohet një material që vihet në dispozicion të interesuarve për përmirësimin e punës.<br><br>Ndërsa pyetesoret për cdo pedagog dhe lende, |

| | |
|---|---|
| | nuk publikohen por ato përdoren në vlerësim dhe analize nga dekani, pergjegjesi i departamentit dhe i interesuari, dmth pedagogu i lëndës, cka eshte e drejte.<br><br>Nuk realizohet vleresim me shkrim që të jete i dokumetuar ne dosje dhe e sherbeje si forme e vleresimit te performance sesi edhe per kahasushmeri me periudhen e kaluar. |
| **Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm. | **Kriteri 1 dhe 2** Sipas RVB "Universiteti publikon rregullisht informacione dhe statistika", në lidhje me ecurine e programit të studimit. Por ky publikim që theksohet ne këtë raport është thjesht për nevoja te brendshme dhe kalon nëpër kanalet zyrtare të komunikimit. Nuk ka publikim të mirëfilltë as në internet dhe video apo në forme të broshurave etj. |
| **Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë. | **Kriteri 1**- është traditë hartimi i raporti vjetor për universitetin, mbi aktivitetet mësimore mbi vleresimin e ecurise se programeve te studmit si pjese e raportimit të detyrueshem ndaj MAS.<br><br>**Kriteri 2**- Institucioni punon mbi bazën e politikave që synojnë përmirësimin e cilësisë së së programeve të studimit.<br><br>Por material të shkruara specifikisht për këto politika që synojnë përmirësimin nuk ka, pavarësisht se ecet në këtë fryme dhe mbi bazën e strategjisë së zhvillimit të institucionit |
| **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;<br>**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;<br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë | **Kriteri 1** – Po, Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; kronologjia e akreditimit është; *Akreditimi fillestar* institucional dhe është në vitin 2006, Akreditimi i dytë, me Urdher Ministri Nr.375, te dates 18.10.2007<br>Dhe *se treti*, Ri-Akreditimi Periodik me Urdhër të Ministrit nr. 136, date 25.03.2016<br>**Kriteri 2**- Sikurse treguam në kriterete e më sipërme të kësaj rubrike, institucioni përdor disa instrumeta që kanë në bazë metodologjinë e universitetete partnere – dhe ky eshte nje avantazh i tij,të cilat janë vetem për përdorim të brendshem<br>**Kriteri 3** - kemi theksuar edhe tek Standardi II.7 që ndonëse nuk ka politika eksplicite te vecanta, në strategjinë e ketij institucioni eshte |

| | |
|---|---|
| publikuar. | pranishme fryma e ketyre politikave<br><br>**Kriteti 4** -Po Institucioni përdor mekanzima formale sikurse jane Komitetet e Përbashkëta Teknike zhvillojnë mbledhje të përvitshme ku mbas analizimit të cilësisë së mësimdhenies dhe mbi këtë bazëpër përmiresimin edhe të programit të studimit.<br>**Kriteri 5**- Angazhimi i studenteve, zyrës së cilësis, sekretarisë mësimore, zyrës së personelit, publikmet mbi programet dhe nivelin e cilësië që kërkohet për akreditim dhe punësim, së bashku edhe me praninë e universiteteve dhe te stafit partner italian, jane forma të ndergjegjesimit si te stafit edhe te studentëve mbi domosdoshmerine e cilesise dhe te garantimit të saj si një proces i vazhdueshem.<br><br>**Kriteri 6**- institucioni kryen nje pune te mire per garantimin e cilësise nepermjet zyrs se cilesise, mekanizmave qe perdor dhe formve te tjera si mbledhjet e komiteteve te perbashketa etj, por strategjia, politika dhe procedurat nuk jane te publikuara ne forme eksplicite, ndaj ky eshte edhe nje drejtim i permiresimit te punes se adhme |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Kriteret per rubriken e garantimit të cilësisë, mund ti quajmë ***pjesërisht të plotësuara*** sepse ndersa ka nje pune mjaft te mire praktikisht per te garantuar kete cilesi, dhe kjo edhe per merite te stafit te perzgjedhur cka u evidentua edhe nga biseda me studentet e kursit, ka *mangesi ne dokumentacionin e strategjise dhe politikave ne vijueshmeri,* (Strategjia e institucioni ne periudhen 2013-2014 dhe 2016-2017 është e përgjithshme dhe jo shume e qarte, aq me teper nuk mund të konsiderohet në kuptimin e plotë si plan strategjik kur eshte per 2 periudha secila nga 2 vjecare dhe nuk eshte eshtrire tej vitit 2017) si edhe publikimi i raporteve mbi cilesine eshte me se shumti ne kanalet e brendshme zyrtare te komunikimit.
Nuk mund të konsiderohet raport mbi cilësinë materiali i ofruar nga me emertimin "*Perceptimi i studenteve mbi procesin didaktik*"
Duhet te publikohet nje raport i hartuar nga Njesia e Cilësisë së institucionit, qe te jete me i gjere, me analize dhe objektiva per permiresim te punes ne vitin pasues akademim etj. Vetem perceptimi i studneteve ne pak faqe, eshte vetem nje pjese e se teres. Ndërkohë që nuk ka vlerësim me shkrim nga titullarët(dekan/ shef departamenti) për performancen e pedagogut- cilësi mësim dhëne, aktivitet didaktik dhe shkencor etj.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

## 7. Programi i studimit, organizimi i tij

### Pjesa përshkrimore

Sipas dokumentit dt 20.11.2015 të formosur nga zv rektori Shehu, UNZKM dhe Alma Mater Studiorum-Universiteti i Bolonjës, bazuar në urdhërin e MAS datë 12.11.2015 , aktivizojnë për vitin akademik 2015-2016 programin e përbashkët të studimit "Master profesiona në "*Ngritje dhe Zhvillim i Sipermarrjes ne Sektorin e Turizmit*" ka nje kohezgjatje nje vjecare" dhe me 60 kredite. Po në këtë dokument janë të përcaktuara qartë edhe profili profesional i tij si edhe qëllimi i tij (të cilat janë dhënë përbledhurazi në pjesën hyrëse të këtij

Periudha kohore e programit të studimit është një 1 vit akademik te ndare në 2 semestra (60 kredite). Bazuar ne vlersimet standarde , nje kredit (ECTS) vleresohet me 25 ore pune te studentit , ku përfshihen leksione, seminare, praktikat, provimet dhe pergatitjes se tezes se diplomes.

Ky program, nga totali 25 orësh, 6 janë orë të ore kontakti t drejtpërdrejtë në klase dhe 19 ore studim individual, pra më shume se 75% janë në favor të punës individuale.

Studenti duhet të përgatisë një projekt kursi (tezë diplome) në përmbyllje të studimit, e cila vlerësohet me 6 kredite. Cdo student ka një udhëheqës/mbikqyrës–lektor të universitetit partner. Teza duhet të ketë sens të theksuar aplikativ.

Në përfundim, diplomimi shoqërohet edhe me vlerësimin me note, e cila kalkulohet si mesatare aritmetike e te gjitha notave te marra ne provimet e kurseve integruara gjate gjithe programit te studimit se bashku me noten vleresuese te tezes se diplomes.

Mësimi zhvillohet në dy gjuhë, shqip dhe italisht, sepse në përfundim jepet diplomë përbashkët, shqiptare dhe italiane, si dhe për të lehtësuar proçesin e mësimdhënies dhe të studimit të studentëve.

Lektorët dorëzojnë pranë zyrës së Koordinatorit të Fakultetit syllabuset për çdo program lënde.

Sylabuset bashkangjitur dokumenatcionit që na është ofruar, kanë nuk i kanë të gjitha elementet si; përmbajten e lëndës dhe e moduleve, modaliteti i provimit të lëndës dhe detyrat e kursit nëse parashikohet, bibliografia etj. (sipas dokumentacionit të dhene). Ndaj duhet të përmirësohet përmbajtja

Programi i studimit mbështet në një literaturë të ngjashme me atë që ofrohet në universitetin e Bolonjës.

Biblioteka, është e pasur dhe ne hard copy dhe online ( shte spjeguar gjeresisht ne rubriken perkatese). Mangesi, e theksuar edhe ne pjesen perkatese eshte mungesa e literatures shqip. Asnjë burim as në hard copy dhe as akses online.

Plani mësimor është sikurse përshkruhet në tabelësn 6 në aneksein në fund të raportit

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| **Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);<br>**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | **kriteri 1-** Ky program studimi është licensuar për hapje duke marrë akreditimin paraprak për hapje pasi është i organizuar ne module dhe i vleresuar me ETCS, dmth me sistemin europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve<br><br>**kriteri 2-** Po, ky program masteri është me 60 kredite, ne perputhje me kerkesat ligjore per masterat profesionale me kohë zgjatje nje vjecare. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; | **Kriteri 2**- ky master profesional, sikurse theksohet edhe ne dokumentin e hapjes te UNKZM dt 20.11.2015 të firmosr nga zv rektori Shehu, UNZKM dhe Alma Mater Studiorum-Universiteti i Bolonjës, bazuar në urdhërin e MAS datë 12.11.2015, që ky master synon të pajisë të diplomuarit dhe sipërmarrësit e ardhshëm me kompetenca të përgjithshme dhe specifike për ngritjen e biznesit dhe zhvillimin e sipëmarrjeve të vogla dhe te mesme në sektorin e turizimit, cka rezulton e till edhe ne fakt nga konstatimet tona ne universitet. |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; | **Kriteri 3**-ky master ka nje lidhje logjike me programin bachelor, (i cili është më i gjerë dhe me njohur themelore), që shërben si baze per thellim te metejshem. Sensi aplikativ dhe afrimi i kompetencave të përgjithsjme ekonomike dhe te specializuara mbi manaxhimin e aspekteve ligjore, promovimin dhe rinisjen e aktiviteteve sipermarrese ej, e bejne te mundur qe edhe specialistë nga fusha te tjera te ndiehn komode dhe jo ne veshtiresi adaptimi, studmi dhe arritje te asimilimi efektiv te programit. |
| **Kriteri 4** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi; | **Kriteri 4 dhe 6**- nuk janë të aplikueshem per master profesional |
| **Kriteri 5** Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij; | **Kriteri 5**- sikurse treguam tek kriteri 2. ky program studimi jep kompetenca të përgjithshme me lendet baze qe ofron, ndesa me lendet me profesionale si edhe me kohen e larte te studimit individual(75% e cdo krediti) ben te mundur që këto kompetenca te pergjithshme te harmozohen me ato praktike –profesionale. |
| **Kriteri 6** Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura"dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve; | |
| **Kriteri 7** Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | **Kriteri 7**- bazuar në kritere e pranimit të publikuara se kush mund të aplikojë ne programin master ne sipermarrje turizmi, por edhe sipas RVB (ku janë dhënë me saktësi diploma potenciale) që të jenë të mundshem për të ndjekur kete master, aplikuesit duhet kene diplomë Bachelor ne turizem, ekonomi e manaxhim ne te gjitha profilet si edhe nga Shkencat Juridike, politike dhe Marrëdhenieve Ndërkombëtare; punë sociale etj..<br><br>Diapazoni zgjerohet me tej me diploma në fushën e inxhiniersie, shkencave të natyrës etj.<br><br>Si parakushht; aplikantët duhet të njohin gjuhen italiane si dhe të kenë njohuritë bazë të informatikes.<br><br>Ndoshta ndonje perekuizite per joekonomistet mund te ishin edhe njohurite baze te ekonomiksit dhe biznesit parahyrjes ose me organzimin e kurseve special gjate kohës së ndjekin edhe kurse e detyrushme të masterit. Kjo mund te kerkonte edhe nje plan mesimor/kurrikul me pak te reduktuar se ai qe eshte aktualisht |

| | |
|---|---|
| **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;<br>**Kriteri 2** Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve. | **Kriteri 1** - programi master në sipëmarje turizmi,i ka objektivat te cilat mund të konsiderohen strategjikë e që janë në pajtueshmëri dhe në funksion të strategjisë tonë kombëtare në fushën e turizmit si edhe me objektiva më specifike për kompetenca të përgjithshme dhe profesionale sikurse pëshkruhen edhe dokumentin e hapjes të cituar në këtë rubrike.<br><br>**Kriteri 2** -Kontrolli i studentëve ne kete master behen me anën e detyrave, projekteve dhe provimit , bazuar ne nje sistem notash me 18-30 -duke ndjekur të njëtën mënyrë vlerësimi sikurse universiteti partner |
| **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e tranferimit të krediteve e njohurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;<br>**Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. | **Kriteri 1- Fillimisht programi u ngrit si master ne sipermarrje, por mbas bisedave me institucione dhe eksperte shqiptare, masteri u orientua drejt sipermarrjes ne turizme si nje prioritet. Programi mbështet ne pevojen europiane dhe konkretish asaj italian, universiteti i Bolonjës me eksperience te pasur ne kete fushe ku aplikohet masteri.<br><br>**Kriteri 2** - Në tërësinë e tij, kurrikula i ka të gjitha elementet e kerkuar nga ky kriter që nga objekivat e deri tek plani mesimor, kreditet, menyra e vleresimit, transferimin e njohurive-siaps standardit te universitetit te Bolonjës, duke shtuar me shume vlere, mendojme, edhe arsimit tonë me kete pervoje<br><br>**Kriteri 3-** Kurrikulat janë ndërtuar në bazë të sistemit ECTS, përmbajtja e tij eshte e njejte me ate te universitetit te Bolonjës (cka e ben de facto te jete brenda standardeve europiane), eshte ne peputhje me direktivat ligjore shqiptare dhe ato të kërkuara ndërkombëtare (BE), ndryshe as transferueshmeria e njohurive dhe as njohja e diplomave ne Itali nuk mund te pranohej. |
| **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;<br>**Kriteri 3** Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 4** Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij. | **Kriteri 1-** Ky program ka si synim të parë aftësimin praktik nisur jo vetem nga emertimi por edhe nga menyra e hartimit të kurrikules, por gjithmone duke i dhene edhe bazen e mjaftueshme teorike per kerkimin shkencor<br><br>**Kriteri 2-** Programi master është ngritur nga fakulteti përgjegjegjës i fushës ekonomike (Fakulteti i shkencave ekonomike, politike dhe sociale) si edhe ne perputhje me strategjine e tij te zhvillimit, e cila duhet thene se është në të njëtin drejtim me strategjine tone kombetare per zhvillimin e turizmit, që është e shprehur m1 mirë ne momentin qe bene edhe riformatimin e masterit me orientim nga turizimi<br><br>**Kriteri 3** - Pohojmë se angazhmi i personelit ne pune kerkimore ne kete fakultet eshte i paket |

| | |
|---|---|
| | sepse pedagoget 2/3 jane italiane qe e kryejne aktivitetin kerkimor ne fakultetin italian.<br><br>**Kriteri 4**- Po, puna kerkimore eshte e lidhur me programine studmit sipas fushave te lektoreve , por gjithmone duke ju referuar kriterit 3 te mepartem |
| **Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj. | **Kriteri 1**- ky program studimi është në përputhje me kerkesat e tregut të punës sepse specialsite te pergatitur per sipermarje ne turizem ka shume pak, nderkohe turizimi eshte nje nga deget prioritare te ekonomise dhe prioritet i orientimit startegjik te ekonomise ne teresi<br>**Kriteri 2**- mbeshtetur edhe ne vleresimin ekriterit 1, pohojme se masteri synon plotesimine e nevojave vendase, por synon edhe tregun e huaj nisur nga diploma qe ofrohet e perbashket me univesitetin e Bolonjes.<br>Por eshte dmd rritja e nr te studneteve edhe per kete kriter por edhe per te qene me afer raportit kosto-eficence |
| **Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | **Kriteri 1**- po, e theksuam edhe me lart se nevojat e tregut te punes jane te medha ndersa shpjegimin e perputhjes me nevojat strategjike te ekonomsie kombetare, e kemi shprehur tek standardi I.7 kriteri 1.<br>Turizmi eshte prioritet strategjik kombetar i ekonomise kombetare i cdo qeverie ne Shqiperi ndaj edhe riorientimi i masterit drejt sipermarrje specifikisht ne turizem eshtë bere edhe nga diskutimet me institucione dhe specialsite vendas.<br><br>**Kriteri 2** - Institucioni nuk kryen nje studmi te meireflllet treg dhe per kete nuk ka dokumentacion, por de facto kerkesat dhe orientimi eshte bere si nga kerkesa qe eshte evidente, ashtu edhe nga prioriteti i cituar ne kriterin 1.<br>Parashikimi ka qene per rreth 30 studente, por vonesat burikratike bene qe te hapen me vonese programi dhe kandidatet ne pamundesi, kanë zgjedhur dege te tjera ne universitete te tjera te vendit |
| **Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | **Kriteri 1**- Jo vetëm që nuk bie ndesh por ka marre parsysh edhe sugjerimet ne takimet me institucione dhe specalsitë shqiptarë per ta orientuar programin drejt turizmit<br><br>**Kriteri 2** - Në hartimin e programit të studimit janë marrë parasysh edhe ruajtja e vlerave kulturore kombetare. Gjate hartimit të programit është, sikurse eshte pohuar edhe nga titullaret e institucionit është konsideruar edhe tradita dhe prioritetet e misheruara ne ligjine ri te turizimit, |

| | |
|---|---|
| | i cili ka ne fokus, vec te tjerave, edhe ruajtjen e vlerave kombetare. |
| **Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike; | **Kriteri 1-** Ky kriter nuk eshtë objekt i këtij vlerësimi |
| **Kriteri 2** Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike. | **Kriteri 2-** Sic e kemi theksuar edhe ne pejsen pershkruese dhe ne vlerësime ne kritere te tjera, e ripohöjme se programi realizohet me kohe te plote, me kohezgjatje nje vjecare dhe me 60 kredite ECTS |
| **Kriteri 3** Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë). | **Kriteri 3-** Nuk shtë objekt vleresini ky kriter |
| **Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;<br><br>**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. | **Kriteri 1 dhe 2** - nga biseda me studentet Informacioni për programin, kurrikulën dhe syllabuset rezultoi se eshte lehtësisht i konsultueshem dhe i askesueshem.<br><br>Këtë ata e arrijnë nga kontaktet dhe komunikimi me koordinatorin e programit dhe stafit administrator (sekretaia msimore). Atyre u ofrohet ky informacon edhe ne 'hard copy' kur behen pjese si studentë të masterit dhe njekohesisht edhe ne formë elektronike ne ëeb-in e universitetit |
| **Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.** | |
| **Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;<br>**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën. | **Kriteri 1-** Po, në planin e studimit specifikohet që diplomimin parashikohet brenda nje viti akademik me kusht që tëkenë brnda afateve marrë provimet dhe nr e plote prej 60 kreditesh te parashikuara ne programin e studimit.<br><br>**Kriteri 2-** Nuk është objekt vlerësimi për këtë program studimi |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Kriteret e kësaj rubrike **i konsiderojme rreth 85-90% të plotësuara.** Programi i studimit është hartuar në bazë të legjislacionit tonë, është me 60 kredite ECTS, me kohëzgjatje një vit, ka në bazë të tij prioritetin qe ka turizmi në ekonominë kombetare, synon përgatitjen e specialistëve sipas nevojave që ka kjo industri, mbeshtetet edhe ne ruajtjene vlerave kombetare ne kete fiushe.
Syllabsuet e lendeve *duhet të plotësohen* me të gjitha elemenete e duhur per pergatitjen dhe vleresimine njohurive te marra nga studentët, të cilën kanë akses te plote dhe e marrin informacionin mbi programin, lendet dhe modulet e tij neperjet koordinatorit, sekretarisë mësimore ne kontaket qe kane, ne forme 'hard copy' si edhe ne faqen e ëeb-it te institucionit.
Si *mangesi* tjeter, qe duhet plotesuar: studim i tregut të punës (pavarësisht se në hartimin e programit institucioni dhe personat pergjegjes janë konsuktuar me specialiste dhe instutucione te specializuara)

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

Mësim dhënia në programim master 'Ngritja dhe zhvillimi i sipërmarrjës në turizëm' zhvillohet në mjediset e UNZKM në një godinën e re njekatëshe "Cassa Rossa". Struktura e procesit mësimor është e ngjashme me ato të unicersiteteve të vendit. Pra, është e ndarë në leksione, seminare, mikrotëze në formëne një projkti individual me mbikqyrje ngan nje lekstor. Ve cketyer, cka e ben te vecante është një praktik njëjavore në Itali n strukturat turiztike italiane..

Nga analiza e planit mësimor tezulton se cdo lende ka të detyrushëm frekuntimin e ½ së orëve në auditor. Ngarkesa e lendeve eshte javore me 18 ore leksione në auditor.

Me qëllim tërheqjen ne programin master edhe te studenteve, të cilët janë të punësuar mësimi zhvillohet mbasdite.

Vlerësimi bëhet me notë me sistemin italian ne intervalin 18 nota më e letë kaluese dhe 30 nota më e partë e vleresimit.

Nga dokumentacioni si edhe nga bisda me studentët. Këtë vit akademik, praktika u realizuar në Rimini, ku studentët theksuan se mësuan mjaft nga ato cka pane, si edhe seminaret, vizitat ne ndermarrje turistike si dhe nga bisedat e realizuara gjate kesaj periudhe kohore. Zakonisht praktika kryhet në përfundim të masterit, me qëllim që studneti të jenë në gjendje të përvetësojë sa më shumë praktikisht nga ato që ka mësuar në auditorë si edhe të jetë më i qart praktikisht për projektin e kursit, pra tezën e diplomës.

Teza/projekti ka disa kërkesa të vecanta të dokumetuara me shkrim; studimi duhet te jete individual, ne formen e nje plani biznesi për ngritjen e një ndërmarje turistike, Për përgatitjejn e kesaj teze me 6 kredite, ka edhe kërkesa nga pikëpamja e mënyres së hartimit, të numrit të faqeve, raportet midis aspektete teorike-akademike dhe anës praktike, - kerkesa sipas tyre të universitetit të Bolonjës.

Finalizimi është mbrojtja para një komisioni me disa anëtarë- ku më parë është verifikuar për cdo projekt nëse punimi u përmbahet kërkesave të parashtruara dhe nës eehste nje punim individlau origjinal.

Vlerësimi përfundimtar kalkulohet si rezltat i mesatares së notave të gjithë lëndëve të programit të masterit së cilës i shtohen pikët e marra gjatë mbrojtjes së diplomës.

Nota shprehet në njëqid e dhjetë (110) dhe ka një minimum kalues prej 66/110 dhe një maksimum prej 110/110.

Në lidhje me ngarkesën vjetore, ajo në total është 650 orë (dmth mbi normën minimanle të kërkuar nga lgjislacioni) dhe ndahet:

*Leksione 46%*

*Seminare 15.5%*

*Paktikë profesionale 38.5%*

*Totali 100% (650 orë)*

Pra, skurse duket nga kjo shpemdarje, pjesa praktike së bashku me seminarete zene mbi 50 %- gjë që lidhet me orientimin praktik –formues që synon program master.

Ky synim nuk është është i reflektuar sa duhet në hartimin e syllabustit, (materiali që disponojmë) i cili I ruan de facto standardet të kërkuara, dhe njeherezi kanë vene theks formimit dhe vlerësimit ne format e ndryshme te aplikuara në seminar, por nuk janë të reflektuara në pjesën përshkrimore të tij

Konkretisht struktura e vlereisimit, cka eshte e pasqyruar drejt ne RVB se bashku me elementet e tjere te kesaj rubrike, janë si vijon:

*Frekuentimi dhe aktivizimi 30%*

*Detyra dhe laboratore 20%*

*Provimi përfundimtar 50%*

Provimi, sikurse eshte tradita e sistemit arsimor Italian, eshte me goje dhe me shkrim.

Aktivizimi i studenteve ne komponenete e aktivitetit të njësise (sikurse duket edhe nga tabela 16 e RVB )në formën e punës shkencore individuale te pedagogeve, ne punen shkencore te departamentit, fakultetit apo edhe te projekteve shkencore me bashkepunime te tjera, eshte inekzistente. Cka përbën një mangësi dhe një objektiv të domodoshem per vitin akademik 2016-2017 ne vijim.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

Për aplikimin dhe pranimin-rregjistrimin në programin e studimit Master, procedurat janë në përputhje me udhezimet e MAS dhe rregulkloren ebrendshme të institucionit. Nëë këtë viut tëarëakademik të celjes së programit, sikurse e kemi pohuar,, për arsye subjektive, mesimi ka filluar me disa muaj vonese, ndaj edhe numri i stduenteve te panuar eshte i paket, 6 persona. Por duhet te theksojme se edhe ne keto kushte te nje numri shume te kufizuar, procesi i përzgjedhjes ka qene rigoroz dhe nuk e kane cenuar parimet e pranimit dke skualifikiar nje kandidat për arsye te mosplotesimit të kritereve te vendosuar

Aplikuesit kanë qene si nga UNZKM qe kanë përfunduar programin bachelor, ashtu edhe nga universitete te tjera qe operojne ne vendin tone

Institucioni, fillimisht shpall publikisht konkursin e pranimit me anën e edokumentacionit si edhe me intervistim me goje me nje komision te posacem

Në shpalljen për konkurim jepen një mënyrë të qartë misioni dhe objektivat e programit, njohurite qe jep, si edhe cilat janë kushtet llojii diplomës dhe kërkesa të tjera si psh njohja e gjuhes italiane eshte kerkese e dmd. meqense mesimi zhvillohet italisht dhe shqip.

Vec ketyre shpallet edhe lloji I dokumntacionit specifik , masa e tarifës së shkollimit etj.

